



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština – Municipality of Prishtina



Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, pika d dhe nenit 14, paragrafi 1 të Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15, qershor 2008), nenit 10, paragrafi 1.6 të Ligjit nr. 04/L-144, për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 35/17 dhjetor 2012), nenit 20, të Rregullores QRK, nr. 23/2013, për përcaktimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, nenit 34, paragrafit 34.1, shkronja d, të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110-391, të dt. 25.02.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 28.03.2019 merr këtë

V E N D I M
PËR DHËNIEN E PRONËS NË SHFRYTËZIM AFATSHKURTËR
NPL "HORTIKULTURA", SHA

- I. **MIRATOHET** propozimi i Kryetarit të Komunës për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim afatshkurtër ndërmarrjes publike komunale "Hortikultura", pa procedurë konkurrimi.
- II. Prona e paluajtshme e dhënë në shfrytëzim, e cekur në pikën I të këtij vendimi, është në pjesët kadastrale: nr. P-71914059-02892-3, Zona kadastrale Prishtinë, PSH, me sipërfaqe 4100 m².
- III. Qëllimi i dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës, të cekur në pikën II të këtij vendimi, është vendosja e 40.000 fidanëve, vendosja e 200 tezgave mobile, si dhe shumë shtëpi nga druri.
- IV. Afati kohor për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës, të përshkruar në pikën II të këtij vendimi, është për 5 vjet.
- V. Prona e paluajtshme komunale e përshkruar në pikën II të këtij vendimi, jepet në shfrytëzim pa kompensim.
- VI. Mënyra dhe kushtet e shfrytëzimit të pronës së paluajtshme do të përcaktohen me kontratë, e cila lidhet dhe nënshkruhet në mes të Kryetarit të Komunës dhe përfaqësuesit të shfrytëzuesit.



- VII. Prona e paluajtshme komunale që jepet në shfrytëzim, e përshkruar në pikën II të këtij vendimi, duhet të evidentohet në librat kadastrale të Komunës.
- VIII. Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen: Kryetari i Komunës, Drejtoria e Pronës dhe Drejtoria e Kadastrit e Komunës së Prishtinës.
- IX. Pjesë përbërëse e këtij vendimi janë:
- kërkesa,
 - skica grafike,
 - certifikata e njësisë kadastrale dhe
 - destinimi për pjesën kadastrale, nr. P-71914059-02892-3.
- X. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS
01-463/01-0073652/19, më 29.03.2019

KRYESUESI I KUVENDIT
Agim Kuleta



The stamp is circular and contains the text: "DIREKTORIA E ADMINISTRIMIT TË PUSHTETIT LOKAL", "OPSTINA PRISTINE", and "REPUBLIKA E KOSOVES".